14/02/2021

Bullgaria: Itinerare në vendet e shenjta do të tërheqin turistë



Ministria e Turizmit do të krijojë destinime për pelegrinazh, me të cilat të inkurajojë vizitat në vendet e shenjta në trojet tona, tha Ministrja e Turizmit Marijana Nikollova gjatë vizitës së saj në Manastirin e Trojanit. Sipas saj në këtë mënyrë do të inkurajohen udhëtimet gjatë tërë vitit dhe do të ndihmohen ekonomitë vendase.

Manastiri i Trojanit është manastiri i tretë për nga madhësia te ne. Çdo vit ai vizitohet nga mijëra turistë, tha gjithashtu Ministrja. Manastiri është themeluar në fund të shekullit të XVI dhe ruan një nga tri ikonat çudibërse të Shën Mërisë me tre duar – kopje e ikonës së vjetër çudibërëse në Manastirin e Hilendarit.








АРХІМАНДРИТ
ПАРТЕНІЙ















— bnr.bg